




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
DREJTORIA E ARSIMIT - EDUCATION DIRECTORATE

Nr./No. 05 - 484

Dt. 15.12.2022

K.K. PODUJEVË



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

RAPORT I PUNËS DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Duke u bazuar në informatat për periudhat kalendarike të viti shkollor iu paraqesim një përmbledhje të raportit të punës të Drejtorisë për Arsim.

Drejtoria e Arsimit ka një plan pune në bazë të të cilit i zhvillon aktivitetet nga sfera e saj.

Drejtoria Arsimit në funksion të përgatitjeve për çdo periudhë të fillimit të vitit të ri shkollor, ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushtet për mbarëvajtjen e procesit mësimor në periudhën e parë të këtij viti shkollor.

Shikuar në përgjithësi, periudha e vitit shkollor 2021/2022 në Komunën e Podujevës, ka përfunduar me sukses. Gjatë kësaj periudhe kohore, janë realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë, në të katër (IV) nivelet e arsimit parauniversitar, por edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura gjatë këtij intervali kohor.

Edukimi parashkollor

Edukimi parashkollor në Komunën e Podujevës zhvillohet në një (2) institucione parashkollore publik, ku procesin edukativ janë duke e vijuar mbi 100 fëmijë të të gjitha grup-moshave. Po ashtu në kuadër të shkollave fillore funksionojnë edhe grupet përgatitore parafillor (5-6 vjeç), ku në këtë vit shkollor, në Komunën e Podujevës janë të regjistruar dhe vijnë në edukimin 985 fëmijë, ku 7 prej tyre janë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, të sistemuar në 58 grupe.

Arsimi fillor

Në Komunën e Podujevës, gjatë vitit shkollor 2021/2022, në arsimin fillor veprimtaria edukativo-arsimore zhvillohet në 37 institucione (shkolla amë) dhe 17 paralele të ndara, me gjithsej 6073 nxënës, të sistemuar në 355 paralele. Prej tyre 87 nxënës janë të nacionalitetit rom, ashkali, egjiptas.

Në arsimin fillor (niveli 1) në periudhën e dytë të vitit shkollor 2021/2022, nota mesatare është 4.35.

Niveli i arsimit	Nota mesatare
Arsimi fillor (Niveli 1)	4.35

Arsimi i mesëm i ulët

Në Komunën e Podujevës, gjatë vitit shkollor 2021/2022, arsimi i mesëm i ulët organizohet në 37 institucione (shkolla amë) dhe 12 paralele të ndara, me gjithsej 5176 nxënës, të sistemuar në 273 paralele. Prej tyre 65 nxënës janë të nacionalitetit rom, ashkali, egjiptas.

Në arsimin e mesëm të ulët (niveli 2) në periudhën e dytë të vitit shkollor 2021/2022, nota mesatare është 3.68

Niveli i arsimit	Nota mesatare
Arsimi i mesëm i ulët (Niveli 2)	3.68

Arsimi i mesëm i lartë

Në vitin shkollor 2021/2022, në Komunën e Podujevës, procesi edukativo-arsimore, në arsimin e mesëm të lartë zhvillohet në 3 institucione (gjimnazi ‘‘ Aleksandër Xhuvani ‘‘, IAAP ‘‘ Isa Boletini ‘‘ dhe IAAP ‘‘ Fan S. Noli ‘‘ me 1 paralele të ndarë fizike të gjimnazit në Orllan. Këtë vit kanë vijuar mësimin 3627 nxënës në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, të sistemuar në 153 paralele. Prej tyre 7 nxënës janë të nacionalitetit rom, ashkali dhe egjiptas.

Në arsimin e mesëm të lartë (niveli 3) në periudhën e dytë të vitit shkollor 2021/2022, në Komunën e Podujevës, nota mesatare është 3.19

Arsimi i mesëm i lartë	Nota mesatare
Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”	3.76
SHMLT “Fan S Noli”	2.95
SHMLE “Isa Boletini”	2.87
Nota mesatare në arsimin e mesëm të lartë	3.19

Në vitin shkollor 2021/2022 në çerdhe, arsimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë janë të regjistruara 15906 nxënës, të sistemuar në 781 paralele.

Bazuar në raportet e dorëzuara nga drejtorët e shkollave, mbi suksesin e arritur në periudhën e dytë të vitit shkollor 2021/2022, rezulton se sukcesi më i lartë është në arsimin fillor, ku nota mesatare është 4.35, pason arsimi i mesëm i ulët, ku nota mesatare është 3.68 dhe në arsimin e mesëm të lartë nota mesatare është 3.19. Nga kjo që u tha më lartë konkludojmë se nota mesatare në nivel komune, në periudhën e dytë të vitit shkollor 2021/2022 është 3.74

Arsimi i mesëm i lartë	Nota mesatare
Niveli 1	4.35
Niveli 2	3.68
Niveli 3	3.19
Nota mesatare në nivel komune	3.74

Regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaz dhe në shkolla profesionale për vitin shkollor 2022/2023, afati i qershorit

Nr.	Shkolla		Nr. nx. të pranuar	Vende të lira	Nr. nx. të papranuar
1.	Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani”	Podujevë	369	99	0
		Orllan	20	0	0
2.	IAAP “Isa Boletini”	Ekonomi-Juridik	420	12	0
		Mjekësi	41	15	22
3.	IAAP “Fan S Noli”		250	104	0
Gjithsej			1100	230	22

Në testin e arritshmërisë në Komunën e Podujevës, qershor 2022, kanë marrë pjesë 1316 semimaturantë. Kurse në konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasën X, kanë marrë pjesë 1122 semimaturantë. Bazuar në këto të dhëna konkludojmë se 194 semimaturantë nuk kanë marrë pjesë në konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasën X, në afatin e qershorit, në Komunën e Podujevës.

1. Testi i Maturës

REZULTATET E TESTIT SHTETËROR TË MATURËS AFATI I PARË - 2022

Numri i maturantëve.....	1289
Pozitiv.....	918 ose 71.21 %
Negativ.....	371 ose 28.79 %

- Gjimnazi “ Aleksandër Xhuvani “ Podujevë

Numri i maturantëve.....	539
Pozitiv.....	486 ose 90.16 %
Negativ.....	53 ose 9.84 %

- SHMLE “ Isa Boletini “ Podujevë

Numri i maturantëve.....	516
Pozitiv.....	334 ose 64.72 %
Negativ.....	182 ose 35.28 %

- SHMLT “ Fan S. Noli “ Podujevë

Numri i maturantëve.....	234
Pozitiv.....	98 ose 41.88 %
Negativ.....	136 ose 58.12 %

REZULTATET E TESTIT SHTETËROR TË MATURËS AFATI I DYTË - 2022

Numri i maturantëve.....	362
Pozitiv.....	164 ose 45.30 %
Negativ.....	198 ose 54.70 %

- Gjimnazi “ Aleksandër Xhuvani “ Podujevë

Numri i maturantëve.....	48
Pozitiv.....	30 ose 62.50 %
Negativ.....	18 ose 37.50 %

- SHMLE ‘‘ Isa Boletini ‘‘ Podujevë

Numri i maturantëve.....	176
Pozitiv.....	80 ose 45.45 %
Negativ.....	96 ose 54.55 %

- SHMLT ‘‘ Fan S. Noli ‘‘ Podujevë

Numri i maturantëve.....	138
Pozitiv.....	54 ose 39.13 %
Negativ.....	84 ose 60.87 %

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar, edhe:

2. **Testi TIMSS** (nxënësit e kl. IV) pjesëmarrëse një shkollë:
3. **Testi ICILIS** (nxënësit e kl. VIII) pjesëmarrëse 3 SHFMU
4. **Testi PISA** (nxënësit e lindur në vitin 2006, pjesëmarrës nxënësit e 7 SHFMU dhe 3 shkollave të mesme, gjithsej 970 nxënës)
5. **Testi i SEMIMATURËS**, pjesëmarrës 1316 nxënës të klasave të IX, të 37 SHFMU

- **Aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara gjatë kësaj periudhe kohore**

Në funksion të realizimit të punëve dhe detyrave me përgjegjësi, në zhvillimin, përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë së arsimit në shkollat e Komunës së Podujevës, zyrtarët e arsimit gjatë periudhës së parë të vitit shkollor 2021/2022, kanë realizuar vizita në mënyrë sistematike në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Vizitat kishin karakter monitorues dhe mentorues për drejtuesit e institucioneve edukative-arsimore dhe stafin mësimdhënës.

Zyrtarët e arsimit gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik dhe planet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimdhënësve sipas planit, mbështetur në kapacitetet e DKA-së, kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të punësuarve tjerë nëpër shkolla. Kanë përcjellë nivelin e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, nivelin e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile.

Duke e ditur rolin dhe rëndësinë që kanë organet qeverisëse-udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, fokus të veçantë i kemi kushtuar dhe vazhdojmë t'i kushtojmë fuqizimit dhe funksionalizimit të plotë të tyre (Drejtorët e shkollave, Aktivitet Profesional, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Nxënësve), me qëllim që këto organe ta ushtrojnë funksionin e tyre në ngritjen e cilësisë në arsim.

Në vazhden e masave dhe aktiviteteve për zbatimin me sukses të kurrikulës së re të arsimit parauniversitar, MASHT në bashkëpunim me DKA në Podujevë, kanë vazhduar me organizimin e trajnimeve, për të gjithë mësuesit që janë duke punuar me klasat që janë duke zbatuar kurrikulën e re, e që nuk kanë qenë të trajnuar për zbatimin e saj.

Komuna e Podujevës, edhe për këtë vit shkollor ka siguruar transportin në mënyrë të organizuar për të gjithë nxënësit që kanë distancë të largët nga shtëpia në shkollë.

Gjithashtu sa për njohurinë e juaj janë zhvilluar edhe procedurat e prokurimit me kohë lidhur me transportin e nxënësve duke i përfshirë edhe bartjen e nxënësve me nevoja të veçanta.

Në aspektin e sigurisë në koordinim me policinë e Kosovës kemi mbajtur takime dhe kemi kryer punë të përbashkëta ku edhe shfrytëzoj rastin t'i falënderoj për një bashkëpunim të sinqertë.

Funksionalizimi i Ekipit Komunal për Vlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe vlerësimi i të gjitha rasteve të paraqitura për vlerësim;

Hartimi i Planit komunal për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës.

Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit të koordinatorëve të cilësisë,

Kemi hartuar një data bazë të të dhënave për fushën e arsimit, ku si model e kanë kërkuar edhe komunat tjera.

Jemi në vazhden e përmirësimit të infrastrukturës fizike nëpër shkolla, duke krijuar gjithashtu edhe rrethojat për siguri në shkolla.

- **Bursa për nxënës dhe studentë**

Në vitin 2022 kanë përfituar :

Studentë $277 \times 350.00 \text{ €} = 96,950.00 \text{ €}$

Është nënshkruar marrëveshja për renovimin e 7 shkollave me investim për efikasitet me vlerë mbi 500.000,00 €, ku në 3 shkolla veç ka përfunduar punimet, në një shkollë janë duke u kryer punimet ndërsa në 3 shkolla të tjera është nënshkruar marrëveshja dhe vitin e ardhshëm do të realizohen punimet.

Në shkollat që ka përfunduar punimet janë:

- SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë
- SHFMU "Shefki Kuleta" në paralelen e ndarë fizike në Bellopojë
- SHFMU "Luigi Gurakuqi" në paralelen e ndarë fizike në Gërdoc

Në shkollën që janë duke u kryer punimet :

- SHFMU "Enver Maloku" në Podujevë

Ndërsa vitin e ardhshëm do të realizohen punimet në këto shkolla:

- SHFMU "Ali Ajeti" në paralelen e ndarë fizike në Lladoc

- SHFMU "Hamit Sejdiu" në paralelen e ndarë fizike në Pakashticë

- SHFMU "Shefki Kuleta" në Tërrnavë

Realizimi i projekteve nga Drejtoria e Arsimit për vitin 2022

Gjatë vitit 2022 në Drejtorinë e Arsimit janë realizuar një mori projektsh që janë në dobi të rritjes së kushteve infrastrukturore dhe cilësisë në arsim.

- Nga janari i vitit 2022 ashtu siç është premtuar ka filluar furnizimi me shujta për nxënësit e klasave 1-5.
- Janë furnizuar shkollat me inventar në vlerë financiare 140,000 euro.
- Dy shkolla janë furnizuar me kabinete të TIK-ut.
- 6 shkolla janë furnizuar me makina për dysheme.
- Janë krijuar 6 kënde të lojërave për fëmijë.
- Është rinovuar dhe ka filluar puna në Çerdhja e re në qytet.
- Me qëllim të rritjes së sigurisë në shkolla është realizuar projekti furnizimi dhe montimi i kamerave në 14 institucione shkollore.
- Janë nënshkruar disa marrëveshje me kompanitë vendore për realizimin e punës praktike të nxënësve të shkollave të mesme.
- Është realizuar projekti i fituar nga Ambasada Japoneze për pajisjen e shkollës teknike me mjete kabinete moderne.
- Me qëllim të realizimit të praktikës profesionale për nxënësit e shkollave të mesme janë pajisur me mjete kabinetike dhe me mjete të konkretizimit për kabinetin e rrobaqepësisë dhe kabinet të arkitekturës.
- Nga shoqata Shqiptaro-Turke në Bursa të Turqisë është furnizuar shkolla teknike me kabinete të përpunimit të drurit në vlerë mbi 4500 euro.
- Është në fazën e realizimit të marrëveshjes "Ndikimi i rinisë në Mjedis YENI" të nënshkruar me Caritasin Zviceran.
- Ka përfunduar realizimi i projektit "Furnizim me kabinete të shkencave natyrore" për 11 shkolla.
- Janë dhuruar 3 maune me inventar për shkolla nga shoqata "Yjet e Kosovës" nga Gjermania.

- SHFMU “Naim Frashëri” në Podujevë është pajisur me mjete për kabinetin e muzikës dhe SHFMU “Luigi Gurakuqi” në Batllavë janë furnizuar me kabinate të shkencave natyrore nga projekti i IOM-it.
- 20 shkolla janë pajisur me piano.
- Gjimnazi “ Aleksandër Xhuvani” dhe SHFMU “ Dr. Ibrahim Rugova” janë furnizuar me mjete për mirëmbajtje dhe mjete kabinetike nga MASHTI.
- Me MASHT është nënshkruar marrëveshja për themelimin e Qendrës së karrierës në IAAP ” Fan S. Noli” në Podujevë. Tani janë duke u kryer punët përgatitore për fillimin e kësaj qendres së karrierës.
- Janë duke u realizuar projektet: “Përmirësimi i infrastrukturës shkollore”;
- Ndërtimin i shkollës në fshatin Obrancë;
- Ndërtimi i shkollës në fshatin Lluga;
- Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU “ Naim Frashëri “ në Podujevë ;
- Ndërtimi i sallës së sportit në SHFMU “Enver Maloku” në Podujevë;
- Transporti i nxënësve.
- Me qëllim të rritjes së cilësisë në arsim kemi iniciuar procedurën për “Krijimin e një platforme digjitale për shkolla”, aktualisht është në procedura të prokurimit.
- Angazhimi i 40 shkollave në pastrim, aktivitet ky i bashkërenduar me Kryetarin dhe drejtoritë përkatëse.
- Trajnimi i mësimdhënësve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie, trajnime këto në kuadër të projekteve të Bankës Botërore, të fituara nga disa shkolla.

- **Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtar**

Edhe këtë vit DKA ka vazhduar bashkëpunimin me partnerë të ndryshëm ndërkombëtar, siç janë:

- Bashkëpunimi me Organizatën Ndërkombëtare GIZ CDBE me projektin “Shkollat Kampione”, ku nga Komuna e Podujevës janë kualifikuar 3 shkolla, SHFMU “ Xheladin Rekalu ” Podujevë, SHFMU “ Enver Maloku ” Podujevë dhe SHFMU “ Pavarësia ” Siboc.
- Është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Programin ALLED2 “Harmonizimi i Arsimit dhe Aftësisimit me Nevojat e Tregut të Punës” i financuar nga BE me bashkëfinancim nga ADC (Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim). Projekti ALLED2, synon të zvogëlojë varfërinë përmes rritjes së pjesëmarrjes në tregun e punës dhe përmirësimit të punësimit të qytetarëve në Kosovë. Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë kuadrin dhe mekanizmat ligjor në mënyrë që të rrisë cilësinë dhe rëndësinë e programeve arsimore dhe trajnuese, po ashtu të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm. Përfitues nga ky program është IAAP “ Fan S. Noli ” Podujevë.

- **Siguria në shkolla**

Drejtoria e Arsimit synon krijimin e një sistemi arsimor të bazuar në cilësi, gjithpërfishrje dhe llogaridhënie, me mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e komunës së Podujevës. Në funksion të kësaj, DKA do të sigurojë infrastrukturë shkollore moderne, mjedis të sigurt, të qetë dhe miqësor, kuadër profesional dhe kompetent për një mësimdhënie cilësore, që do t'iu mundësojë të gjithë nxënësve zhvillimin maksimal të potencialeve të tyre, në pajtim me aftësitë psikike e fizike të tyre dhe me kërkesat e shoqërisë.

Shikuar në përgjithësi, dhe duke u bazuar në raportet e policisë dhe raportet e drejtorëve të shkollave, si dhe raportet e DKA, në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt.

Këtë konstatim e përforcon edhe më shumë mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në komunën e Podujevës si dhe raportet e drejtorëve të shkollave.

- **Mbledhja me drejtorët e shkollave**

Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore, drejtori i DKA mban mbledhje të rregullta me të gjithë drejtorët e shkollave, në të cilën mbledhje janë trajtohen temat:

- Siguria në shkolla – masat për parandalimin e dhunës në shkolla;
- Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla;

- **Fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i organeve qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollave**

Duke ditur rolin dhe rëndësinë që kanë organet qeverisëse – udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim, por edhe në sigurimin e një mjedisi të qetë e të sigurt në shkolla, fokus të veçantë i kemi kushtuar dhe do të vazhdojmë t'i kushtojmë fuqizimit dhe funksionalizimit të plotë të tyre (Drejtorët e shkollave, Aktivet Profesionale, Këshilli Drejtues i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli i Nxënësve, Këshilli i Klasëve, Këshilli i Arsimtarëve, Shërbimi Pedagogjik-Psikologjik), me qëllim që këto organet ushtrojnë funksionin e tyre në ngritjen e cilësisë në arsim dhe në krijimin një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkolla.

Në këto mbledhje është konstatuar gjendja e sigurisë për secilën shkollë, si dhe propozimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky takim janë përmbledhur në një raport nga secila shkollë dhe janë sjellë në DKA.

Bazuar në këto raporte mund të konstatojmë se gjendja e sigurisë në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë dhe e sigurt.

- **Zgjerimi i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik**

Në Komunën e Podujevës kemi të punësuar 10 psikologë dhe 1 pedagoge, e që shikuar në raport me numrin e nxënësve në Komunën e Podujevës është i pamjaftueshëm. Po ashtu në kuadër të funksionalizimit të shërbimit psikologjik e pedagogjik dhe për trajtim sa më të mirë të nxënësve me nevoja të veçanta janë punësuar edhe 9 asistente për trajtimin e kësaj kategorie.

- **Sigurimi i transportit të nxënësve**

Komuna e Podujevës siguron transport të organizuar për të gjithë nxënësit që kanë distancë nga shtëpia në shkollë mbi 4 km., si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e komunës së Podujevës, që i vijnë në mësimet në klasat për fëmijët me nevojat e veçanta, në SHFMU “Kongresi i Manastirit” në Gllamnik.

Kemi siguruar dru dhe pelet për ngrohje për të gjitha institucionet edukativo- arsimore.

- **Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shkollore**

Me qëllim të krijimit të infrastrukturës moderne, mjedisit të sigurt dhe miqësor për nxënës, komuna e Podujevës, në kuadër të planifikimeve të saj, edhe për këtë vit ka ndarë buxhet për ndërtimin, zgjerimin dhe renovimin e hapësirave shkollore.

- **Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave**

Rrethojat e oborreve të shkollave ndikojnë në ngritjen e sigurisë së shkollave, dhe duke marrë parasysh këtë fakt, komuna e Podujevës ka bërë investime të konsiderueshme në këtë drejtim. Shumica e shkollave kanë rrethojat e tyre, mirëpo në do të vazhdojmë edhe këtë vit të ndërtojmë rrethojat edhe në ato shkolla ku rrethojat janë dëmtuar apo nuk ka fare rrethoja.

- **Ndërtimi dhe rregullimi i trotuareve për këmbësor**

Janë ndërtuar shumë trotuare qoftë në zona urbane, por edhe të atyre rurale, të cilat kanë ndikuar në sigurinë e këmbësorëve në përgjithësi, e sidomos sigurinë e nxënësve. Trotualet e ndërtuara afër rrugëve që dërgojnë për në shkolla, iu mundësojnë qytetarëve, e sidomos nxënësve lëvizje shumë më të sigurt, andaj kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t'u jep përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla.

- **Bashkëpunimi i DKA-së me Policinë e Kosovës**

Drejtoria e Arsimit, për sigurimin dhe garantimin e një mjedisi të qetë dhe të sigurt në shkollë bashkëpunon ngushtë me Policinë e Kosovës. Në të gjitha organizimet dhe aktivitetet që kemi realizuar, e që e kemi vlerësuar të nevojshme të jenë policia, e kemi pasur mbështetjen tyre. Gjithashtu kemi zhvilluar edhe takime të drejtpërdrejta qoftë me komandantin e Stacionit të Policisë së Podujevës, qoftë me zyrtarët tjerë, ku i kemi bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme, me qëllim që të jemi më efikas në kryerjen e punëve, detyrave dhe përgjegjësive tona.

Prezenca e policisë në afërsi të shkollave në qytet, sidomos në shkollat e mesme të larta është e nevojshme.

Presim që ky bashkëpunim në mes DKA dhe Policisë të vazhdojë edhe më tutje, në mënyrë që të sigurojmë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë komunitetin shkollor.

- **Instalimi i kamerave të sigurisë**

Nga takimet e rregullta që kemi zhvilluar me drejtorët e shkollave, si dhe nga takimet që i kanë zhvilluar Këshillat Drejtuese të Shkollave në Komunën e Podujevës, por edhe me palë tjera të interesit, është identifikuar nevoja që në shkolla të instalohen kamerat e sigurisë.

Andaj edhe me këtë vitë ne po e përmbyllim instalimin e kamerave në të gjitha shkollat.

- **Sfidat**

Përkundër vlerësimeve të gjendjes së sigurisë së përgjithshme në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës si të qetë, të sigurt dhe stabile, megjithatë kemi çështje, fatmirësisht jo të shumta, të cilave ende nuk kemi mundur t'u japim zgjidhje të plotë. Disa nga to janë:

- Pandemia COVID-19
- Incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve,
- Dëmtimet në objektet e disa shkolla nga persona të panjohur, pas përfundimit të orarit mësimor,
- Lokalet afër shkollave,
- Qentë endacak,
- Komunikacioni,

DKA në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë akterët përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe për ruajtjen e rendit dhe sigurisë (drejtorinë e shkollave, organet e shkollave, policinë, QPS, OJQ etj.), do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mjedis të qetë dhe të sigurt në të gjitha institucionet edukative-arsimore.

- **Organizimi i garave për nxënës *****

Drejtoria Komunale e Arsimit në Podujeve në bashkëpunim me Shoqatën e Matematikanve të Kosovës , kanë organizuar garën “Olimpiada Matematike 2023.

*Vendin e parë **(I)** nga klasët e **IX-ta** e fitoi: **Rilind Gashi, SHFMU "Jetullah Gashi"- Dobërdol**

*Vendin e dytë **(II)** nga klasët e **IX-ta** e fitoi: **Agnesa Visoka, SHFMU "Musli Dumoshi"- Dumosh**

*Vendin e parë **(I)** nga klasët e **X-ta** e fitoi: **Diellorita Xhemajli, Gjinnazi "Aleksandër Xhuvani"-Podujevë**

*Vendin e dytë **(II)** nga klasët e **X-ta** e fitoi: **Argjenda Hoxha, SHME "Isa Boletini"- Podujevë**

*Vendin e parë **(I)** nga klasët e **XI-ta** e fitoi: **Blinera Stublla, SHMT "Fan S. Noli"- Podujevë**

*Vendin e dytë **(II)** nga klasët e **XI-ta** e fitoi: **Gerti Parduzi, Gjinnazi "A. Xhuvani"- Podujevë**

*Vendin e parë **(I)** nga klasët e **XII-ta** e fitoi: **Leonita Shabani, SHME "Isa Boletini"- Podujevë**

*Vendin e dytë **(II)** nga klasët e **XII-ta** e fitoi: **Blerta Ferati, Gjinnazi "A. Xhuvani"- Podujevë**